



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

### KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, drejtuar me email pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ju bëjmë me dije se:

1. *A ka marrë dhe trajtuar Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ankesa lidhur me diskriminimin me bazë gjinore të vajzave dhe grave politike në Shqipëri? Nëse po, lutem të më vini në dispozicion të gjithë informacionin e disponueshëm mbi këto raste.*

Lidhur me pyetjen e sipërcituar, KMD nuk ka trajtuar ankesa me pretendim diskriminimin me bazë gjinore të vajzave dhe grave në politikë në Shqipëri.

2. *A ka marrë dhe trajtuar Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ankesa lidhur me pretendimin se komuniteti LGBT synon të zëvendësojë termat "nënë" dhe "baba" me "prindi 1" dhe "prindi 2"? Nëse po, lutem të më vini në dispozicion të gjithë informacionin e disponueshëm mbi këto raste.*

Lidhur me pyetjen e sipërcituar, KMD nuk ka trajtuar ankesa të cilat në objekt të tyre nuk kanë patur pretendimin se komuniteti LGBT synon të zëvendësojë termat "nënë" dhe "baba" me "prindi 1" dhe "prindi 2".

3. *A ka marrë dhe trajtuar Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ankesa lidhur me diskriminimin me bazë gjinore të aktivistes Zhaklin Lekatari apo personazhe të tjera të njohura në jetën publike në Shqipëri? Nëse po, lutem të më vini në dispozicion të gjithë informacionin e disponueshëm mbi këto raste.*

Bazuar ne LIGJ Nr. 9887, datë 10.3.2008 PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE (Ndryshuar me Ligjin, Nr. 48/2012, F.Z. 53) (Ndryshuar me Ligjin, Nr. 120/2014, F.Z 160), nuk janë të dhena që mund të vihen në dispozicion nga Koordinatorin për të Drejtën e Informimit.

Ju vime në ndihmë me vendimet e KMD për të gjitha vitet

<https://www.kmd.al/vendime-te-komisionerit-2023/>

dhe raportet vjetore

<https://www.kmd.al/raporte-vjetore/>